



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr. 338/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 05.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Hedhet e palejuar ankesa e parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, A.nr.338/2025 e datës 24.01.2025, paraqitur kundër subjektit politik Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datën 24.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, në cilën pretendohet se më 3 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE! në Skenderaj ka identifikuar banerin/posterin e vendosur në hapësirat/rrugët publike të kandidatit për deputet të PDK-së, Xhevahir Geci, në rrugën "Bekim Berisha", përball QKMF, në Skenderaj.

Ky baner/poster është vendosur pa leje, në hapësirën e jashtme të ndërtesës kolektive-publike. Me këtë veprim kandidati dhe subjekti politik PDK kanë bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës - LZP.

Provë: Fotografi që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në kundërshtim me LZP

Në përgjigjen në ankesë të Subjektit Politik PDK, theksohet se ankuesi me qëllim të vendosjes në lajthitje të PZAP, ka parashtruar ankesë të njëjtë sikurse ankesa nr. 173/2025, respektivisht të njëjtit lokacion, veçse me fotografi nga këndi i ndryshëm (shih ankesën nr.173/2025 të bashkëngjitur në këtë përgjigje), ndërsa në këtë ankesë gjithashtu me qëllim të lajthitjes ka ndërruar adresën në Rr. "Bekim Berisha", ndonëse adresa gjendet në Rr. "18 qershori". Pikërisht

mbi këtë ankesë, PZAP me vendimin Anr.173/2025, ka refuzuar ankesën e ankuesit, pasi që ka konsideruar se z. Xhevahir Geci ka vepruar në përputhje me nenin 34, par. 1, nën par. 1.2 të Ligjit Nr. 08/L-288 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës-LZP dhe se me veprimet e tij nuk ka vepruar në shkelje të kësaj dispozite.

Ndërsa, kandidati për deputet z. Xhevahir Geci, më datë 22 janar 2025, ka lidhur kontratën Nr. protokoli 04/2025 për hapësira reklamuese me kompaninë N,Sh "Foto Kabashi", e cila në nenin 1, nën par. 1.2 të saj është përcaktuar se qiramarrësi do të marrë në shfrytëzim hapësirën reklamuese nga data 22 janar 2025 e deri më datë 11 shkurt 2025, e cila dëshmon pa mëdyshje faktin se z. Xhevahir Geci ka ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e pëlqimit nga shfrytëzuesi i kësaj hapësire, para vendosjes së banerit/posterit.

Provë: Kontrata nr. prot 05/2025 për Hapësira Reklamuese, e lidhur ndërmjet N.Sh "Foto Kabashi" si qiradhënës dhe z Xhevahir Geci si qiramarrës, e datës 22janar 2025.

Paneli pasi qe shqyrtoj lejueshmërinë e ankesës gjeti se:

Ankesa është e palejuar

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga Subjekti Politik LVV, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën Anr.173/2025 të paraqitur me datën 23.01.2025 nga po i njëjti subjekt politik LVV, kundër subjektit politik PDK, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr. 173/2025 të datës 26.01.2025 subjektit politik PDK është refuzuar ankesa si e pa bazuar. Ndërsa pas shikimit dhe krahasimit të shkresave të lëndës qëndrojnë të bazuara pretendimet në përgjigje në ankesë se banerat për rastin në fjalë kanë të bëjnë me vendosje për Rr.18 Qershori në Skenderaj e jo siç thuhet në këtë ankesë për rr. Bekim Berisha-Skenderaj.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.173/2025 të datës 26.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesë.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115.1 dhe 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 338/2025 më datën 05.02.2025

Kryesues e Panelit,

Ramush Bardiqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.